



**DPA**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E ARKIVAVE**



**INSTITUTI I HISTORISË  
“ALI HADRI”**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NË FUSHËN E BOTIMEVE DHE QASJES SË LIRË NË FONDET ARKIVORE  
NDËRMJET  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE  
DHE  
INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI”**

Në mbështetje dhe në zbatim të Ligjit 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, ndryshuar me Ligjin nr. 27/2024, datë 4.4.2024), si dhe të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenit 26, nënparagrafi 1.1, dhe Statutit nr.01B-195 dt. 31.10 2024 të Institutit të Historisë “Ali Hadri”, neni 24, nënparagrafi 1.13, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Instituti i Historisë së Kosovës “Ali Hadri” nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi:

**Neni 1**

**Qëllimi i marrëveshjes**

1. Qëllimi i marrëveshjes është nxitja e kërkimit shkencor në fushën e studimeve albanologjike dhe të përmbledhjes së dokumenteve, që janë prioritete kyçe të të dyja institucioneve.
2. Marrëveshja realizon bashkimin e burimeve të specializuara njerëzore dhe arkivore të dy institucioneve, për realizimin me cilësi më të lartë dhe kostoeftektivitet të prioriteteve kyçe të sipërpërmendura.
3. Për Institutin e Historisë, marrëveshja mundëson lehtësimin dhe nxitjen e studimeve të studiuesesve të Institutit të Historisë në fushën e shkencave albanologjike, si një interes institucional dhe kombëtar.
4. Për Drejtorinë e Përgjithshme e Arkivave, marrëveshja mundëson botime cilësore, në fushën e përmbledhjes së dokumenteve dhe pasurimin e bibliotekës, si një interes institucional dhe kombëtar.
5. Instituti i Historisë angazhohet të dhurojë pranë Arkivit Qendror Shtetëror, kopje digjitale të dokumenteve të mbledhura nga studiuesit e këtij instituti në arkiva të huaja që kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve.
6. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në kuadër të informimit dhe gjithpërfshirjes në marrjen e infomacionit do t'i shërbejë këto dokumente në sallën e saj të studimit.

7. Në fund të 6 muajve, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe Instituti i Historisë do të bëjnë rakordimin e sasisë së dokumenteve që janë marrë, falas, nga punonjësitë e Institutit të Historisë.

## **Neni 2**

### **Objekti i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka si objekt bashkëpunimin midis dy institucioneve të lartpërmendura në fushën e kërkimit shkencor dhe botimeve, nëpërmjet qasjes së lirë në fondet arkivore dhe botimeve të përbashkëta të lidhura me to.

## **Neni 3**

### **Qasja e lirë në dokumente**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) merr përsipër të mbështesë studiuesit e Institutit të Historisë (IH) me burimet arkivore në formë dixhitale pa pagesë, por jo më shumë se 100.000 imazhe në vit.
2. Instituti i Historisë, bazuar në këtë marrëveshje, do të pajisë punonjësit e vetë me një autorizim me kohëzgjatje të caktuar, jo më shumë se një vit, në të cilin do të specifikohen tema e studimit dhe/ose sasia maksimale e imazheve që mund të merren pa pagesë. Shuma totale e imazheve të të gjitha autorizimeve nuk mund të jetë më e lartë se sasia e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave do të japë imazhet falas të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, në përputhje me rregullat e caktuara në sallën e studimit, për shërbimin e dixhitalizimit sipas kërkesës (on demand).
4. Nëse studiuesit me autorizim do të konsultojnë njësitë origjinale, për shkak se ato nuk janë të dixhitalizuara sipas rregullave të sallës së studimit në DPA, ata do të kenë të drejtë të fotografojnë të plota pa pagesë këto njësi ruajtje. Një kopje e fotografive të kryera prej tyre do t'i dorëzohet DPA-së. Sasia e imazheve të fotografuara do të përlllogaritet në totalin e imazheve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

## **Neni 4**

### **Bashkëpunim në fushën e botimeve**

1. Instituti i Historisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave do të botojnë bashkërisht minimumi një botim përmbledhje dokumentare në vit. DPA do të vejë në dispozicion bazën burimore, ndërsa studiuesit e IH do të kryejnë të gjitha proceset e tjera të punës studimore, edituese dhe botimin e veprës.
2. Tema për përmbledhjen dokumentare do të sugjerohet nga studiuesit e IH dhe miratohet nga IH dhe DPA, çdo fund viti për vitin pasardhës. Tema duhet të jetë e ndërlidhur me ngjarje historike, personazhe apo periudha të caktuar të historisë së shqiptarëve në tërësi dhe shqiptarëve të Kosovës në veçanti.
3. Instituti i Historisë merr përsipër që botimet monografike të realizuara nga studimet e kryera sipas autorizimeve të parashikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje, të kenë të evidentuar se ato janë botime të kryera me mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, në kapak ose në faqen e përcaktuar për të dhënat e përgjithshme të monografisë, si edhe në CIP-katalogimin e saj.

4. Nga botimi i realizuar në bashkëpunim, Instituti i Historisë do t'i dhurojë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, 1/4 e tirazhit të botimit.
5. Instituti i Historisë i dhuron bibliotekës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit të gjitha botimet e tjera të tij në 2 (dy) kopje.
6. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave i dhuron 2 kopje nga botimet e saj bibliotekës së Institutit të Historisë.
7. Palët pajtohen që të kenë pjesëmarrje të ndërsjellë në këshillat botuese dhe shkencore të revistave shkencore: "Kosova", "Burime", "Arkivat Shqiptare" dhe botimeve të tjera të institucioneve përkatëse.

## Neni 5

### Bashkëpunimi në fusha të tjera

1. Palët angazhohen në organizimin e konferencave, simpoziumeve, tryezave dhe kongreseve shkencore, në fushat e interesit të përbashkët.
2. Palët angazhohen në promovimin e përbashkët të personaliteteve dhe momenteve kyçe të historisë kombëtare nëpërmjet ekspozitave apo mjeteve të tjera informuese, përfshirë edhe rrjetet sociale të institucioneve përkatëse.
3. Këmbimi i kontakteve dhe bashkëpunimi në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar të dy institucioneve, dhe forcimi i partneritetit me institucione tjera kërkimore, shkencore dhe arkivore.
4. Caktimi i një koordinatori përgjegjës nga secili institucion për bashkërendimin e aktiviteteve kërkimore, shkencore dhe promovuese.
5. Palët pajtohen që të dërgojnë ftesa njëra-tjetrës me rastin e organizimit të aktiviteteve shkencore dhe në raste të veçanta të jenë bashkëorganizatore.
6. Palët marrin përsipër të promovojnë botimet respektive të institucioneve në vendet e tyre. DPA në bashkëpunim me IH në Tiranë botimet e institutit dhe anasjelltas.

## Neni 6

### Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje është lidhur për një afat prej katërvjeçare dhe do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj. Marrëveshja mund të ripërtërihet me vullnetin e Palëve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë më 24.04.2026 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën Shqipe. Të dyja tekstet janë njëjloj autentike.

1. Marrëveshja mund të ripërtërihet me vullnetin e Palëve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

## Neni 7

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të Memorandumit

1. Palët zotohen që të zgjidhin çfarëdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje përmes konsultimeve miqësore e në mirëbesim mes tyre.
2. Secila Palë mund të tërhiqet nga kjo marrëveshje në çdo kohë duke paraqitur një arsye të vlefshme.
3. Tërheqja nga Memorandumi i sjell efektet 30 ditë pas njoftimit dhe nuk cënon veprimtaritë që janë në proces.

**PËR  
DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË ARKIVAVE**

**Dr. Endrit MUSAJ**



**PËR  
INSTITUTIN E HISTORISË  
“ALI HADRI”**

**Prof. Dr. Teuta SHALA- PELI**

